



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 245 Prot.

Tiranë, më 03/02/2022

### V E N D I M

Nr. 32, Datë 03/02/2022

Bazuar në nenin 32/1/a, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri) mori në shqyrtim ankesën nr.205 Regj., datë 09.11.2021, paraqitur nga ankuesi A.Z (në vijim ankuesi), kundër Shkollës së Mesme Teknike Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër (në vijim Shkolla), në të cilën ankuesi pretendon diskriminimin e vajzës së tij F.Z, për shkak të “aftësisë së kufizuar”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi deklaron se është babai i një fëmijë me aftësi ndryshe, të quajtur F.Z. Ankuesi shpjegon se, vajza e tij ka ndjekur Shkollën Speciale 3-Dhjetori në Shkodër dhe ka pasur një ecuri shumë të mirë. Me rekomandim të Shkollës Speciale, ankuesi deklaron se vajzën e kanë dërguar tek Shkolla e Mesme Profesionale “Kol Margjini” në Shkodër, në mënyrë që vajza të integrohej më tej dhe të fitonte disa aftësi profesionale që mund t’i përdorë në të ardhmen.

Më datë 27 shtator 2021, ankuesi deklaron se ka shoqëruar vajzën në shkollë dhe ajo ka vazhduar të ndjekë shkollën rreth 1 muaj. Ankuesi shpjegon se, dokumentacionin për regjistrimin e vajzës në shkollë e ka dërguar përpara datës së fillimit të vitit shkollor, sipas kërkesës së drejtoreshës, e cila sot pretendon se vajza nuk është pranuar ndonjëherë në shkollë dhe nuk është regjistruar. Ankuesi pretendon se kjo nuk është e vërtetë, pasi vajza ka ndjekur shkollën për 1 muaj dhe më pas drejtoresha nuk e ka pranuar më vajzën në ambientet e shkollës, me pretendimin që fëmija ka nevoja të veçanta dhe nuk ka mësues ndihmës. Ankuesi shpjegon se gjatë periudhës 1 mujore që vajza ka ndjekur shkollën nuk ka patur probleme dhe se shkollën e frekuentojnë në mënyrë të rregullt dhe 3 fëmijë të tjerë me aftësi ndryshe, të cilët gjithashtu kanë ardhur nga Shkolla Speciale 3-Dhjetori dhe kanë qenë në të njëjtën klasë, sikurse vajza e tij. Ankuesi informon se vajza e tij ka ndjekur mësimin në Degën Përpunim Druri, në klasën ku mësuese kujdestare është znj.D.B.

Ankuesi pretendon se ky është një diskriminim që po i bëhet vajzës së tij e cila ka nevojë dhe kërkon vazhdimisht që të shkojë në shkollë, sepse është ndjerë mirë dhe afeksionohet me shokët

dhe shoqet, fakt ky që vërtetohet nga vlerësimet e komisionit të shkollës ku ka qenë më parë vajza. Ankuesi shprehet se një situatë e tillë ka ndikuar në gjendjen psikologjike të vajzës, pasi ajo ka qëndruar 1 muaj në këtë shkollë. Largimi nga shkolla ka ndikuar shumë tek vajza, e cila kërkon vazhdimisht që të rikthehet. Ankuesi deklaron se, në datë 28.10.2021, e ka telefonuar drejtoresha e Shkollës që të mos e çonte më vajzën në Shkollë. Ankuesi pretendon se i ka kërkuar një dokument të shkruar në lidhje me këtë, por ajo nuk ka pranuar.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri që të marrë masa për pranimin e vajzës së tij në shkollë dhe që vajza të mos diskriminohet, pasi ajo ka nevojë urgjente të integrohet dhe të vendoset mësuesi ndihmës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1547/1 prot., datë 25.11.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Shkolla, në lidhje me pretendimet e ngritura nga ankuesi. Me anë të kësaj shkrese është vendosur në dijeni për ankesën dhe problematikën Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

1.1 Me shkresën nr.178 prot., datë 02.12.2021<sup>1</sup>, Shkolla ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën duke parashtruar sa vijon:

Z. A.Z është paraqitur në ambjentet e Shkollës Profesionale “Kolë Margjini”, Shkodër, për të regjistruar vajzën e tij të quajtur F.Z. Ai ka lënë në sekretarinë e shkollës deftesën e vajzës dhe i është kërkuar të sjellë epikrizën, në të kundërt nuk është proces i kryer i regjistrimit. Pra vajza nuk

---

<sup>1</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1547/2 prot., datë 06.12.2021.

regjistrohet nëse nuk paraqitet edhe epikrizë, meqënëse vajza vinte nga Shkolla “3 Dhjetori”. F, nuk është rekomanduar nga kjo Shkollë për të ndjekur studimet pranë Shkollës Pyjore, por prindërit e saj janë nisur nga fakti se në këtë shkollë kanë ardhur për regjistrim edhe 3 nxënës të klasës së Fjonës.

Prindërit e F. nuk e kanë sjellë epikrizën e vajzës, por janë paraqitur në ambientet e Shkollës vetëm në datën 27 shtator kur filloi viti i ri shkollor 2021-2022, duke sjellë F. në ambientet e Shkollës. Nga drejtuesja e shkollës i është komunikuar se vajza nuk mund të qëndrojë në shkollë pa sjellë epikrizën, për të parë rekomandimin e komisionit mjeko ligjor, për F.. Prindi i F. ka pretenduar se vajza do ta përjetojë keq dhe është lutur që të qëndrojë të paktën atë ditë, me qëllim që të mos fyhet. Në respekt të një fëmije me aftësi ndryshe është lejuar që vajza të qëndrojë për pak atë ditë, ndërkohë që prindi të sillte epikrizën.

Pasi prindi depozitoi epikrizën, u konstatua se aty cilësohej që F. duhej të shoqërohej në çdo moment nga një person tjetër. Prindit i është komunikuar se vajza nuk mund të regjistrohej në Shkollë, pasi nuk kishin person që mund ta shoqëronte apo mësues ndihmës, që t’i vinte në ndihmë vajzës. Shkolla realizon tre herë në javë praktika profesionale në ambientet e Shkollës dhe në biznes dhe rrezikshmëria për të ndodhur aksidente është shumë e lartë, madje deri edhe në fatkeqsi më të mëdha me rrezik për jetën, pasi punohet me makineri prerëse të drurëve. Të gjitha këto arsye iu sqaruan prindërve të F., por ata kanë vijuar të sjellin vajzën në ambientet e Shkollës edhe më pas, duke kërkuar me insistim, deri edhe në kërcënime të shumta për jetën nga ana e z. Z. Ata kërkonin që vajza të mos diskriminohej pa marrë një përgjigje përfundimtare nga AKPA dhe nga ZVA Shkodër për të ngritur Komisionin Multidisiplinor, i cili do të vlerësonte nëse vajza duhej të regjistrohej në Shkollë apo jo. Sapo erdhi përgjigja nga ZVA Shkodër, që Komisioni Multidisiplinor nuk ngrihet për shkollat profesionale që ZVA nuk i ka nën juridiksionin e saj, prindërve iu është dhënë përgjigja përfundimtare që vajza nuk mund të regjistrohej në Shkollën Pyjore.

Shkollat profesionale bazohen për regjistrimet në shkollë në udhëzimin nr.14, datë 27.05.2021, neni 16, ku theksohet që pranohen vetëm nxënës që s’kanë mbushur akoma moshën 18 vjeç, ndërkohë që F. në 10 tetor, mbushte moshën 19 vjeçe, pra e ndanin vetëm pak ditë nga plotësimi i moshës për të mos u pranuar. Gjithashtu neni 17, pika 4, sqaron se, nxënësi regjistrohet nëse paraqet të gjithë dokumentacionin, i cili publikohet në rrjetet sociale dhe në ambientet e shkollës, ndërkohë që A.Z, kishte lënë pa sjellë epikrizën e vajzës.

Regjistrimi i F. ishte i pamundur për shkak të epikrizës, ku specifikohet se kishte nevojë për shoqërim nga një person në çdo moment, ndryshe nga nxënësit e tjerë që vazhdojnë studimet në këtë shkollë, në epikrizat e të cilëve nuk theksohet shoqërimi nga persona të tjerë. Shkolla pyjore nuk ka diskriminuar asnjë nxënës me aftësi ndryshe, përkundrazi i ka pranuar dhe mbëtetur këta nxënës dhe kjo vërtetohet nga fakti se në shkollë ka nxënës me aftësi ndryshe. Prindërit e F. propozuan që një nxënëse të rrinte në klasë dhe F. kur të kishin praktikat profesionale. Drejtuesja e Shkollës nuk e ka pranuar një propozim të tillë, pasi në këtë mënyrë kjo nxënëse do të privohej nga e drejta për të mësuar për faktin se duhet të shoqëronte shoqen e saj.

1.2 Me shkresën nr.4284/2 prot., datë 15.12.2021<sup>2</sup>, AKPA ka informuar Komisionerin duke parashtruar sa më poshtë vijon:

Në lidhje me problematikën e referuar, Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-së është vënë në dijeni nëpërmjet kërkesës së shkollës së mesme pyjore “Kolë Margjini”, mbi nevojat për mësues ndihmës si dhe kërkesës për informacion dërguar me emailin e datës 03.11.2021, të znj.Z.K, përfaqësuese e shoqatës MEDPAK. Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e përcjellë nga ana e shkollës mbi problematikën, AKPA ka konstatuar se:

Prindi i F.Z, është paraqitur në Shkollën e Mesme Teknike Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër për të regjistruar vajzën në drejtimin e përpunimit të drurit, pa praninë e saj. Vajza është shoqëruar në Shkollë nga prindërit dhe ka ndjekur një orë mësimore, pa u regjistruar. Gjatë kësaj kohe ajo ka patur kriza shëndetësore dhe për këtë arsye Shkolla i ka kërkuar prindërve që të paraqesin një dokument që vërteton gjendjen shëndetësore të fëmijës.

Prindërit më datë 28.09.2021, kanë depozituar në Shkollë vendimin e KMCAP Shkodër nr.8389 prot., datë 25.05.2021, me anë të të cilit është vendosur që F.Z ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër. Shkolla i është drejtuar gjithashtu ZVA Shkodër me email, për ngritjen e Komisionit Mjekësor, për shqyrtimin e dosjes së Fjonës, por edhe të tre nxënësve të tjerë, por nga ana e ZVA është marrë përgjigje me një e-mail zyrtar të datës 02.11.2021, ku thuhet se : “Ky komision mund të ngrihet vetëm për shkollat që janë nën juridiksion të ZVA-së, pra jo për shkollat profesionale”, referuar urdhrin të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, nr.31, datë 28.01.2020 “*Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”.

Shkolla nuk ka në organikë mësues ndihmës dhe dega e kërkuar e vajzës, përpunim druri, paraqet rrezikshmëri shumë të lartë për shëndetin për shkak të makinerive të ndryshme që përdoren në praktikën profesionale në këtë drejtim. Për këtë arsye, vajza nuk është regjistruar nga ana e shkollës dhe nuk është pranuar më të vijoje të rrijë në shkollë pa plotësuar kushtet e përcaktuara në vendimin e KMCAP Shkodër. Në regjistrin e klasës së X, dega përpunim druri, nuk figuron e regjistruar F.Z. Shkolla ka kërkuar pranë AKPA që të mundësohet në strukturë një mësues ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara.

AKPA sqaron se, në zbatim të nenit 64, pika 1, të ligjit nr.69/2012 “*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, ende nuk është miratuar udhëzimi i përbashkët me Ministrinë e Shëndetësisë. Pra, nuk ka një bazë ligjore të miratuar deri më tani për të rregulluar këtë proces në arsimin profesional. MFE ka përgatitur draft-udhëimin “*Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit profesional*” dhe AKPA është në

---

<sup>2</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1547/2 prot., datë 06.12.2021.

pritse të miratimit të udhëzimit. Në Kreun III të draft udhëzimit të sipërcituar, “*Ngritja e Komisionit Multidisiplinar dhe detyrat e tij*”, përcaktohen detyrimet e AKPA-së si më poshtë:

1. AKPA ngre Komisionin multidisiplinar të përbërë nga mjek pediatër (kur është e mundur mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe një punonjës nga AKPA, i cili është kryetar.
2. Komisioni, me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prondërore të fëmijës, ose të drejtorit të ofruesit të AP-së, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij.

AKPA shprehet se pretendimi për diskriminim i nxënës me aftësi ndryshe, nuk qëndron për faktin se në këtë shkollë janë regjistruar disa nxënës me aftësi ndryshe të ardhur po nga shkolla speciale “3 Dhjetori”. Për këta nxënës prindërit kanë depozituar në Shkollë vendimet e komisionit mjeko-ligjor, ku thuhet që ata nuk kanë nevojë për shoqërues.

Nxënësja F.Z është e datëlindjes 20.10.2002, pra ka kaluar moshën 18 vjeç, e cila është kriter regjistrimi në shkollat e mesme profesionale, bazuar në pikën 3, të nenit 16 “*Parimet në arsimin e mesëm profesional*” të udhëzimit të MFE-së nr.14, datë 27.05.2021 “*Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit*”, përcaktohet që: “*Në ofruesin e AFP-së, në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm profesional pranohen nxënës të moshës jo më të madhe se 18 vjeç dhe lejohen të ndjekin shkollën deri në moshën 22 vjeç*”.

Si konkluzion, për shkak të moshës së F.Z, vendimit të KMCAP-së Shkodër që përcakton se ajo ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, si dhe për faktin që Shkolla nuk ka të miratuar mësues ndihmës në strukturë, me të drejtë nuk është kryer regjistrimi i kësaj nxënëse.

2. Në datën 13.12.2021, ankuesi ka dërguar me *email* kundërshtimet e tij në lidhje me përgjigjen e Shkollës, duke parashtruar ndër të tjera:

Ankuesi pretendon se epikriza e vajzës së tij është dorëzuar ditën e parë të shkollës dhe pretendimi i Shkollës se epikriza është dërguar më vonë është i pabazuar. Ankuesi thekson se vajza ka frekuentuar rregullisht Shkollën për një muaj dhe drejtoresha duhet të vepronte sipas rregullave nëse vajza nuk mund të rregjistrohej në shkollë dhe jo ta mbante fëmijën 1 muaj pa regjistruar.

Sipas ankuesit në dijeninë e tij edhe fëmijët e tjerë me aftësi të kufizuara që ndjekin Shkollën sikurse vajza e tij kanë kujdestar. Fëmijët e tjerë me aftësi të kufizuara janë me të njëjtat karakteristika si F., prandaj pretendimet e shkollës janë të pabazuara. Nëse fëmija ka nevojë për mësues ndihmës duhet që drejtuesja e shkollës t’ a kërkojë një gjë të tillë. Shkolla nuk ka ngarkesa në nxënës dhe fëmijët mund të mbulohen nga mësuesit aktualë, por kuptohet që duhet të caktohet

mësuesi ndihmës. Nëse ambientet e shkollës paraqesin një rrezik të lartë për nxënësit, atëherë do të ishte mirë që të inspektoheshin ambientet e shkollës për të parë gjendjen e fëmijëve të tjerë me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me moshën e lejuar për regjistrimin në shkollë, ankuesi pretendon se merret për bazë mosha në momentin e regjistrimit, që në këtë rast është data e fillimit të shkollës ose disa ditë përpara se të fillojë shkolla. Ankuesi hedh poshtë si të pavërtetë pretendimin se ka kërcënuar drejtuesen e shkollës.

3. Me shkresat nr.1547/3 prot., datë 14.12.2021 dhe nr.1547/4 prot., datë 14.12.2021, Komisioneri kërkoi informacion shtesë nga Shkolla dhe nga AKPA. Shkolla ktheu përgjigje në lidhje me kërkesën e sipërcituar për informacion me shkresën nr. 20 prot., datë 28.01.2022<sup>3</sup>, ndërsa AKPA ktheu përgjigje me shkresën nr. 4284/2 prot datë 20.12.2021<sup>4</sup>.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.**

Bazuar në informacionin dhe provat e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi se, ankuesi është banues në Dobraq, Shkodër dhe është babai i një vajze me aftësi të kufizuara të quajtur F.Z, e datëlindjes 20.10.2002. Bazuar në vendimin nr.8389, datë 25.05.2021, të Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), Rrethi Tiranë, Niveli i Parë Neurologji-N/Kirurgji, i cili funksionon pranë Shërbimit Social Shtetëror, F.Z është vlerësuar si person me aftësi të kufizuara, grupi i parë. Referuar këtij vendimi, KMCAP, gjithashtu ka vlerësuar se, F.Z, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Vajza e ankuesit, F.Z, ka përfunduar arsimin 9 vjeçarë, në Shkollën 9-vjeçare Speciale “3 Dhjetori”, Shkodër, duke u pajisur me Deftesën e arsimit bazë, lëshuar në datë 13.07.2021. Me qëllimin që vajza e tyre të integrohej dhe të fitonte aftësi profesionale që mund ti përdorë në të ardhmen, ankuesi ka kërkuar që vajza e tij të regjistrohej në një shkollë profesionale dhe konkretisht në Shkollën e Mesme Teknike të Pyjeve “Kolë Margjini”, Shkodër, klasa X, dega përpunim druri. Në kushtet kur Shkolla ka refuzuar të regjistrojë vajzën e tij, ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se Shkolla ka diskriminuar vajzën e tij F.Z, për shkak të aftësisë së kufizuara.

Arsimi dhe formimi profesional në Republikën e Shqipërisë rregullohen sipas përcaktimeve të Ligjit nr.15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” (në

<sup>3</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 200 prot., datë 31.01.2022

<sup>4</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 27 prot., datë 07.01.2022.

vijim Ligji nr.15/2017). Referuar nenit 2/ç, qëllimi i këtij ligji është që të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP). Në nenin 5/a, të këtij ligji përcaktohet se: “Sistemi i AFP-së bazohet në këto parime themelore: a) Parimi i gjithëpërfshirjes: Sistemi i AFP-së ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim. Ndërsa në nenit 7, Ministria përgjegjëse për AFP ka ndër të tjera këto kompetenca: a) harton politika në fushën e AFP-së, si dhe monitorn zbatimin e tyre; b) harton dhe propozon bazën ligjore e nënligjore në fushën e AFP-së; c) Monitoron dhe garanton cilësinë në sistemin e AFP-së; ç) siguron burimet e nevojshme njerëzore, financiare e logjistike për fundkionimin e AFP-së. Referuar Vendimit nr. 503, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, fusha e arsimit dhe formimit profesional është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e politikave shtetërore në këtë fushë.

Në nenin 12, pika 1 dhe pika 2/a, të ligjit nr. Ligji nr.15/2017, përcaktohet: “1. AFP-ja ofrohet nga institucionet publike dhe private. 2. Institucionet ofruese të AFP-së janë: a) shkollat e mesme profesionale.” Sa më sipër, Shkolla e Mesme Teknike Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër, është një shkollë profesionale dhe referuar nenit 12/2/a, të Ligjit nr.15/2017, ajo konsiderohet sipas këtij ligji ofrues publik i AFP-së. Referuar nenit 1, germa “b”, të Ligjit nr. 15/2017, aspektet e sistemit të AFP-së, rregullohen në përputhje me sistemin e përgjithshëm arsimor dhe tregun e punës. Bazuar në nenin 24, të ligjit nr.69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, arsimi i mesëm profesional është një nga llojet e arsimit të mesëm të lartë.

Bazuar në nenin 12, të Ligjit nr.15/2017, mënyra e organizimit dhe veprimtaria e shkollës profesionale, rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP-në. Në bazë dhe në zbatim të këtij përcaktimi ligjor është miratuar udhëzimi nr.14, datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave. (udhëzimi nr.14/2021)

Procedurat e regjistrimit në arsimin e mesëm profesional, parashikohen në nenin 17, të udhëzimit nr.14/2021, ku parashikohet si vijon: “Ofruesit e AFP-së publikojnë në mjediset e jashtme dhe në faqen e internetit, një muaj para fillimit të regjistrimeve, këto të dhëna: a) numrin e pranimeve të reja; b) afatet për paraqitjen e kërkesës për regjistrim; c) datat e regjistrimeve. 2. Regjistrimi i nxënësit në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm profesional bëhet me deklaratën tip të plotësuar nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, sipas shtojcës 5 të këtij udhëzimi. Kur një nxënës nuk paraqitet brenda 5 ditëve nga fillimi i vitit shkollor për shkaqe të pajustifikuara, nxënësi tjetër, sipas radhës në listë, gëzon të drejtën e regjistrimit. 3. Dokumentacioni që duhet të paraqitet në sekretarinë e shkollës për regjistrim është: a) fotokopje e noterizuar e dëftesës së arsimit bazë; b) kërkesë me shkrim për drejtimin mësimor që do të ndjekë. 4. Regjistrimi i nxënësit në nivelin

*arsimor pasardhës, brenda strukturës arsimore, bëhet nëpërmjet dokumentacionit bazë, që ofruesi i AFPsë disponon për këtë nxënës.”*

Ligji nr.15/2017 dhe udhëzimi nr.14/2021, nuk kanë parashikime të posaçme lidhur me procedurën e regjistrimit të nxënësve me aftësi të kufizuar dhe për rrjedhojë rregullimi i mësipërm është njësoj i zbatueshëm për të gjithë nxënësit, pavarësisht nëse ata janë ose jo me aftësi të kufizuara.

Me shkresën nr.20 prot., datë 28.01.2022, Shkolla depozitoi kopje të shpalljeve të realizuara për fillimin e regjistrimeve për vitin shkollor 2021-2022. Referuar shpalljes, rezulton se, dokumentet e nevojshme për regjistrimin në shkollë janë : 1.Deftesë origjinale e shkollës 9-vjeçare (ose kopje e noterizuar), 2. Certifikatë personale, 3. Kërkesë me shkrim për profilin, 4. Aplikim që plotësohet në shkollë (Formularë). Bazuar në aktet e administruara rezulton se, ankuesi ka depozituar për regjistrimin në shkollë të vajzës së tij F.Z, formularin e aplikimit për regjistrimin e nxënësve në klasën e X të arsimit të mesëm profesional nënshkruar në datën 13.09.2021, deftesën e shkollës 9-vjeçare, certifikatën personale të vajzës së tij. Drejtimi i zgjedhur ka qenë “Përpunim Druri”.

Shkolla pretendoi gjatë shqyrtimit të ankesës se, regjistrimi i nxënësit në arsimin e mesëm profesional bazuar në udhëzimin e mësipërm neni 17/4, bëhet kur prindi depoziton të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Meqënëse ankuesi nuk kishte depozituar epikrizën e vajzës së tij F., shkolla nuk kishte kryer regjistrimin e kësaj nxënëse. Nga kopjet e regjistrave të kasave të X, në të dy drejtimet mësimore “përpunim druri” dhe “pyjore” nuk rezulton që vajza e ankuesit, F.Z të jetë regjistruar në shkollë.

Në datë 27.09.2021, ditën e fillimit të vitit të ri shkollor 2021-2022, F.Z, vajza e ankuesit, është shoqëruar nga prindërit në shkollë. Sipas drejtueses së Shkollës, F. është lejuar që të qëndrojë për pak në Shkollë në ditën e fillimit të vitit shkollor, deri sa prindi të sillte epikrizën, dokument i cili i ishte kërkuar më parë për regjistrimin e vajzës, por që ankuesi nuk e kishte depozituar. Ankuesi pretendoi se ka depozituar epikrizën e vajzës së bashku me dokumentacionin tjetër të kërkuar për regjistrimin në Shkollë përpara fillimit të shkollës. por nuk depozitoi ndonjë akt për të provuar këtë pretendim. Ndërsa, sipas informacionit të përcjellë nga AKPA, kjo e fundit sqaron se, epikriza e F. është kërkuar nga Shkolla, pasi ajo ditën e parë të shkollës, kur ka qenë duke ndjekur një orë mësimore, e paregjistruar, ka patur kriza shëndetësore. Rezulton se Shkolla dhe AKPA kanë përcjellë dy informacione të cilat bien në kundërshtim me njëra tjetrën. AKPA, nuk dha asnjë informacion se përse Shkolla nuk ka kryer regjistrimin e vajzës së ankuesit, kur ai ka depozituar formularin e regjistrimit dhe deftesën, përpara fillimit të shkollës, që përbëjnë edhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim në shkollë, sipas udhëzimit nr.14/2021.

Komisioneri konstaton se, pretendimi i Shkollës se ankuesi nuk ka sjellë të gjithë dokumentacionin e kërkuar për regjistrimin e vajzës së tij në shkollë, është i pabazuar. Referuar udhëzimit nr.14/2021, epikriza e vajzës që i është kërkuar ankuesit për regjistrimin e saj në shkollë, nuk është një dokument që kërkohet për regjistrimin e nxënësve në klasën e X të arsimit profesional. Shkolla në kundërshtim me rregullat dhe kriteret e vendosura në udhëzimin nr.14/2021, por edhe shpalljen që ka realizuar për fillimin e regjistrimeve në shkollë, i ka kërkuar ankuesit që të depozitojë



epikrizën e vajzës, një dokument që nuk kërkohet për regjistrimin e nxënësve në klasën e X të arsimit profesional. Shkolla e ka bërë këtë kërkesë, pasi ka konstatuar se vajza e ankuesit ka ndjekur shkollën speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Referuar vendimit të KMCAP, i cili ka përcaktuar se F.Z, ka nevojë për kujdesin e vazhdueshëm të një personi dhe në kushtet kur nuk ka në organikën e saj mësues ndihmës, Shkolla nuk ka pranuar që të kryejë regjistrimin e vajzës së ankuesit. Sipas Shkollës, prindërit e F. kanë vazhduar të insistojnë me kërkesën për të regjistruar vajzën e tyre në shkollë.

Rezulton se Shkolla i është drejtuar Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër (ZVAP Shkodër) me një kërkesë për vendosjen në dispozicion të Komisionit Multidisiplinar, të ngritur pranë saj. Me një email datë 2.11.2021, ZVAP Shkodër i ka kthyer përgjigje duke u shprehur si vijon : “ *Ju keni paraqitur një kërkesë me nr.142 prot datë 13.10.2021, protokolluar në ZVAP Shkodër me datë 14.10.2021 me nr.3537 prot. Në kërkesën që keni paraqitur ju kërkoni “prezencën e anëtarëve të Komisionit Multidisiplinar të ngritur nga ZVAP Shkodër për vlerësimin e dosjeve. Ju bëjmë me dije se ky Urdhër ngrihet bazuar në Ligjin nr.69, datë 21.06.2012 “Për sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” për institucionet arsimore që janë nën juridiksionin e ZVAP Shkodër. Shkolla e Mesme Profesionale “Kolë Margjini” nuk është nën juridiksionin e ZVAP Shkodër, prandaj Komisioni i ngritur nuk mund t’ju vihet në dispozicion.”*

Shkolla shprehet se ka dhënë përgjigjen përfundimtare se vajza e ankuesit nuk mund të regjistrohej në shkollë, pas përgjigjes së mësipërme të ZVAP Shkodër dhe në kushtet kur në organikën e shkollës nuk ka një mësues ndihmës. Asnjë nga këto “vendimarrje” të Shkollës për refuzimin e regjistrimit të vajzës së ankuesit nuk i është dhënë në formë të shkruar ankuesit shoqëruar me arsyet përkatëse për refuzimin e regjistrimit në shkollë të vajzës.

Referuar shkresës nr.142 prot., datë 13.10.2021, rezulton se Shkolla i është drejtuar Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër (ZVAP Shkodër) për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilët janë të regjistruar në shkollë. Ndërkohë Shkolla nuk e kishte regjistruar F.Z si nxënëse, e për rrjedhojë kjo e fundit nuk do kishte mundësi t’i nënshtrohej vlerësimit të mundshëm që mund të ishte bërë nga ana e komisionit multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP Shkodër, pasi nuk figuronte nxënëse e shkollës.

Ligji i posaçëm nr.15/2017, që rregullon arsimin e mesëm mesëm profesional, nuk përmban një rregullim të posaçëm lidhur me regjistrimin në shkollë për personat me aftësi të kufizuara. Ky ligj dhe aktet e tij nënligjore, nuk kanë parashikime të ndryshme për regjistrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, ndërsa rezulton se drejtuesja e Shkollës ka vendosur të mos e regjistrojë vajzën e ankuesit me pretendimin se nuk ishin depozituar të gjitha dokumentat e nevojshme për regjistrimin. Në këtë mënyrë, drejtuesja e Shkollës ka trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme vajzën e ankuesit, duke kërkuar për regjistrimin e saj në shkollë vendimin e KMCAP, në raport me nxënësit

e tjerë që nuk kanë aftësi të kufizuar. Sikurse pranohet nga drejtuesja e Shkollës, ajo kërkon për regjistrimin në shkollë të nxënësve me aftësi të kufizuar paraqitjen e vendimit të KMCAP, një dokument ky që nuk kërkohet për regjistrimin në klasën e X, të arsimit të mesëm profesional.

Drejtuesja e Shkollës prapësoi pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, pasi në shkollë janë regjistruar edhe 3 fëmijë të tjerë me aftësi të kufizuar, të cilët gjithashtu kanë ndjekur shkollën speciale që ka frekuentuar F.Z. Drejtuesja e Shkollës, pretendoi se, referuar vendimit të KMCAP, për nxënësit e tjerë me aftësi të kufizuar, të cilët u regjistruan në shkollë, ndryshe nga F., nuk kishin nevojë për përkujdesjen e vazhdueshme të një personi tjetër. Me shkresën nr.200 prot., datë 28.01.2022, Shkolla vendosi në dispozicion dokumentacionin e regjistrimit të tre nxënësve të tjerë me aftësi të kufizuara dhe konkretisht B.G, F.N dhe E.V. Referuar kopjes së regjistrimit të klasës së X të arsimit profesional pranë kësaj shkolle, rezultoi se, të tre këta nxënës janë regjistruar në drejtimin “Përpunim Druri”. Bazuar në dokumentacionin e regjistrimit të këtyre tre nxënësve, të vendosur në dispozicion nga Shkolla, rezultoi se, këta nxënës janë vlerësuar nga KMCAP, si persona me aftësi të kufizuara “grupi i dytë” dhe nuk kanë nevojë për ndihmës personal/kujdesin e vazhdueshëm të një personi tjetër. Nga ana e AKPA-së, u depozituan gjithashtu tre vendime të KMCAP, që pretendohet se i përkasin nxënësve të cilët janë të regjistruar në Shkollë pasi nuk kishin nevojë për shoqërues. Referuar vendimeve të KMCAP për F.Z, L.P dhe A.K, ata janë vlerësuar persona me aftësi të kufizuar “grupi i dytë” dhe që nuk kanë nevojë për përkujdesjen e vazhdueshme të një personi tjetër/ndihmës personal. Referuar kopjes së fletës së regjistrimit të klasave të X në të dy drejtimet “Pyjore” dhe “Përpunim druri”, të vendosura në dispozicion nga AKPA, nuk firuron që L.P, A.K dhe F.Z të jenë nxënës të regjistruar në klasën e X të arsimit profesional pranë kësaj shkolle.

Referuar vendimeve të KMCAP-së për nxënësit B.G, F.N , E.V, të cilët janë nxënës të regjistruar në klasën e X të arsimit profesional për vitin shkollor 2021-2022, si dhe L.P, A.K dhe F.Z, vendimet e KMCAP-ve të të cilëve u depozituar nga AKPA, si nxënës me aftësi të kufizuara të cilët gjithashtu nxjekin shkollën, rezultoi se, të gjashtë këta nxënës, janë persona me aftësi të kufizuar të grupit të dytë. Nga ana tjetër, vajza e ankuesit, F.Z, është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar e grupit të parë. Bazuar në mënyrën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas ligjit nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të tij, rezultoi se vlerësimi si person me aftësi të kufizuara “grupi i parë” tregon një shkallë më të rëndë dëmtimi, në krahasim me vlerësimin si person me aftësi të kufizuara “grupi i dytë”. Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson se fakti që nxënës të tjerë janë të regjistruar në shkollë, nuk rrëzon *a priori* pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Zbatimi i trajtimit të barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi garantohet edhe midis llojeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Komisioneri vlerëson të pabazuar pretendimin e Shkollës se vajza e ankuesit, F.Z nuk mund të regjistrohej në klasën e X, për shkak të moshës. Rezultoi se F.Z është e datëlindjes 20.10.2002. Në ditën e fillimit të vitit shkollor 2021-2022, në datë 27.09.2021, F.Z nuk kishte mbushur moshën 19 vjeç, por e plotësonte atë në datën 20.10.2021.

Ligji nr.15/2017, nuk vendos kufizime në lidhje me moshën e nxënësve për ndjekjen e arsimit të mesëm profesional. Kufizime në lidhje me moshën e nxënësve që duan të ndjekin klasën e X të arsimit të mesëm profesional, përcaktohen nga neni 16, pika 2, të udhëzimit nr. 14/2021, ku parashikohet : “2. Në ofruetin e AFP-së, në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm profesional pranohen nxënës të moshës jo më të madhe se 18 vjeç dhe lejohen të ndjekin shkollën deri në moshën 22 vjeç.”

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, vajza e ankuesit në momentin e fillimit të vitit të ri shkollor 2021-2022, ka qenë jo më shumë se 18 vjeçe, në përputhje me kriterin e moshës të vendosur nga udhëzimi nr.14/2021, duke mos patur pengesa në drejtim të moshës për regjistrimin e saj në klasën e X të arsimit të mesëm profesional pranë kësaj shkolle.

Komisioneri konstaton se, nëse moshja do të ishte një shkak që pengonte regjistrimin në shkollë, atëherë nuk do të ishte e nevojshme që shkolla t'i drejtohej ZVAP Shkodër për vendosjen në dispozicion të Komisionit Multidisiplinor ose të kërkonte vendimin e KMCAP. Justifikimi i Shkollës se praktika profesionale përbën rrezik për F.Z, në kushtet kur moshja mund të përbënte një shkak të bazuar për refuzimin e regjistrimit, është i panevojshëm.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se F.Z, vajza e ankuesit A.Z është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pafavorshme dhe të pabarabartë, duke iu refuzuar regjistrimi në klasën e X, të arsimit të mesëm profesional, pranë Shkollës së Mesme Teknike të Pyjeve “Kolë Margjini”, Shkodër, për vitin shkollor 2021-2022.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në ankesën e depozituar ankuesi pretendon diskriminimin e vajzës së tij F.Z, për shkak të aftësisë së kufizuar. Referuar vendimit të KMCAP, rezulton se F.Z, ka diagnozën “P.C.S.I. Epilepsi e gjeneralizuar. Prapambetje mendore” dhe është vlerësuar person me aftësi të kufizuara, grupi i parë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar faktin se F.Z mbart shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të aftësisë së kufizuar.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.**

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 57 të Kushtetutës sipas të cilit “*Kushdo ka të drejtën për arsimim*”. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se : “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta*”, si dhe “*Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë*” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.” Ky ligj parashikon disa forma nëpërmjet të cilave mund të shfaqet sjellja diskriminuese, duke përcaktuar në nenin 3, pika 2, se : “2.“*Diskriminim i*

*drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.” Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit gëzon një mbrojtje të veçantë sipas ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar Në nenin 17/1ç dhe 17/2, të këtij ligji, përcaktohet: “1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre. 2. Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”*

Në bazë të nenit 5, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivist të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>5</sup> (KDKPAK), e cila përbën standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara. Konventa ka pranuar se, aftësia e kufizuar, është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar, rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët. Ky përcaktim synon gjithëpërfshirjen dhe jo përjashtimin. KDKPAK, ka sanksionuar vlerësimin e aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social, një qasje bazuar në të drejtat e njeriut, ndryshe nga modeli mjekësor, mbi bazën e të cilit është vlerësuar aftësia e kufizuar, deri para miratimit të kësaj Konvente. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Sipas nenit 3, të KDPA barazia dhe mosdiskriminimi, janë parime që përshkojnë të gjitha parashikimet e Konventës, por edhe e drejtë e veçantë, parashikuar nga neni 5, ku sanksionohet : “1.

---

<sup>5</sup>Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

*Shtetet palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe sipas ligjit dhe se kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji. Shtetet palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat. 3. Me qëllim që të promovohet barazia dhe të eliminohet diskriminimi, shtetet palë duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të siguruar që është arritur akomodimi i arsyeshëm. 4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk duhet të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj konvente.”*

KDPAK ndalon çdo formë diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ky parim ka të bëjë jo vetëm me mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në raport me personat e tjerë, por edhe brenda kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Konventa në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Në frymën e Konventës, është miratuar, Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, që ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

*Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët. Në gërmën “b”, të pikës 2, të nenit 5, të Ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikohet se: “Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën të dëshirojnë...”.*

KMCAP ka vlerësuar F.Z, si person me aftësi të kufizuar e grupit të parë, duke vendosur se ajo ka nevojë për kujdesin e vazhdueshëm të një personi tjetër. Vendimarrja dhe veprimtaria e KMCAP bazohet në dispozitat e ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 57/2019 ) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Bazuar në kuadrin e mësipërm ligjor, ky rekomandim i KMCAP do të thotë që F.Z, si përsôn me aftësi të kufizuara në bazë të vlerësimit të nevojave të saj, ka të drejtën të ketë “ndihmës personal”. KMCAP, nuk bën vlerësimin e

nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara për ndjekjen e arsimit, përfshi këtu arsimin e zakonshëm apo atë profesional.

*“Ndhmësi personal”, është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme. Ky është një përkufizim i unifikuar i cili përcaktohet në nenin 3/2 të ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim ligji nr.93/2014) dhe nenin 4, germa “I”, të ligjit nr. 57/2019. Sipas nenit 8/1 të ligjit nr. 93/2014, i cili është një ligj kuadër i cili udhëheq të gjithë referomimin e legjislacionit në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, përcaktohet se : “1. Ndhmësi personal ofron asistencën personale në cilësinë e ndihmësit për kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara, shoqëruesit për personat e verbër, interpretuesit të gjuhës së shenjave dhe lehtësuesit në komunikim për personat me paaftësi në të folur dhe në të dëgjuar”. Bazuar në vendimin nr.874, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal”, të Këshillit të Ministrave, pikat 5 dhe 6, përcaktohen detyrat e ndihmësit personal dhe konkretisht : “5. Detyrat e ndihmësit personal përfshijnë, por nuk kufizohen, në detyrat e përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, dhe synojnë t’i vijnë në ndihmë personit me aftësi të kufizuara, për: a) realizimin e veprimtarive për përmbushjen e nevojave themelore për t’u mundësuar atyre të jetojnë me dinjitet; b) shoqërimin jashtë shtëpisë për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fetare; c) shoqërimin për marrjen e shërbimeve sociale, shëndetësore, rehabilituese e integruese dhe shoqërimi për në shkollë për fëmijët e moshës shkollore; ç) marrjen në kohë të mjekimeve, sipas rekomandimit të mjekut; dhe d) mbajtjen e higjienës personale. 6. Mbështetja në komunikim përfshin, por nuk kufizohen te: a) shërbimet e përkthyesit të gjuhës së shenjave; b) ndihma për të komunikuar nëpërmjet ligjërit dhe/ apo shenjave të veçanta; c) ndihma në përdorimin e programeve që ndihmojnë komunikimin përmes figurave; ç) përshtatja e informacionit të shkruar, sipas nevojave.”*

Arsimi i mesëm profesional është një nga llojet e arsimit të mesëm të lartë, por nuk hyn në kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar, legjislacioni shqiptar, në nenin 64/3 të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton si detyrim ligjor që institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të krijojë një komision multidisiplinor, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, vlerëson fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit special për ta është përgjithsisht e përkohshme, përbën një nga parimet e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përcaktuar nga neni 63, i ligjit të sipërcituar. Gjithashtu, referuar parashikimit të nenit 65, pika 3, të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen dhe mësues ndihmës, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Legjislacioni i arsimit parauniversitar, zbatohet njësoj për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, duke përfshirë të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, duke filluar nga arsimi parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë (gjimnazet dhe shkollat e orientuara) por nuk gjen zbatim për arsimin e mesëm profesional, i cili është kompetencë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe rregullohet nga ligji nr.15/2017. Pavarësisht se për arsimin e mesëm profesional nuk gjejmë zbatim parashikimet e ligjit nr.69/2012, i ndryshuar dhe aktet e tij nënligjore që rregullojnë arsimin parauniversitar, sipas nenit 1/b, të ligjit nr.15/2017, rregullimi i aspekteve të arsimit profesional bëhet në përputhje me sistemin e përgjithshëm arsimor.

Detyrat e mësuesit ndihmës në arsimin parauniversitar, përcaktohen dhe rregullohen nga udhëzimi nr.26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”. Referuar detyrave të mësuesit ndihmës të përcaktuara në kreun II, të këtij udhëzimi, rezulton se, mësuesi ndihmës dhe ndihmësi personal, për personat me aftësi të kufizuara, kanë funksione dhe detyra të ndryshme. Mësuesi ndihmës dhe ndihmësi personal, kanë të përbashkët vetëm faktin se ato janë forma të mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, por rregullohen nga legjislacione të ndryshme, synojnë integrimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në drejtime të ndryshme dhe për rrjedhojë kanë funksione dhe kompetenca të ndryshme, të cilat nuk mund të mbivendosen. Pavarësisht se në shkollë mund të ketë nxënës të tjerë me aftësi të kufizuara të cilët sipas vendimit të KMCAP nuk kanë ndihmës personal, kjo nuk nënkupton që këta nxënës nuk kanë nevojë për mbështetjen me mësues ndihmës.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit rregullohet nga neni neni 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.<sup>6</sup>

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkakun i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me

<sup>6</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.



provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht<sup>7</sup>”.*

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se F.Z, vajza e ankuesit, i është nënshtruar një një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke i’u refuzuar regjistrimi në klasën e X, të arsimit të mesëm profesional, pranë Shkollës së Mesme Teknike të Pyjeve “Kolë Margjini”, Shkodër, për vitin shkollor 2021-2022. Rezulton gjithashtu e provuar se, refuzimi për të regjistruar vajzën, ka ardhur për shkak se prindërit e nxënëses nuk kishin depozituar vendimin e KMCAP, i cili nuk është një dokument i nevojshëm për regjistrimin në shkollë dhe kërkohet nga shkolla për nxënësit me aftësi të kufizuara. Komisioneri konstaton se, në rastin objekt shqyrtimi trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesja është pasojë e drejtëpërdrejtë e faktit që F.Z është person me aftësi të kufizuara.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, F.Z i është nënshtruar një trajtimi më pak të favorshëm, në për shkak se është person me aftësi të kufizuara.

Komisioneri konstaton se, në radhë të parë Shkolla nuk duhet të refuzonte regjistrimin e F.Z në shkollë me pretendimin se nuk kishte depozituar vendimin e KMCAP, pasi ky nuk është një dokument që kërkohet për regjistrimin në shkollë. Nga ky moment duke vendosur një kërkesë shtesë ndaj vajzës së ankuesit, por edhe personave me aftësi të kufizuara, Shkolla ka vendosur në kushte të pafavorshme nxënësit me aftësi të kufizuara. Komisioneri vlerëson se, Shkolla me dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar sipas akteve në fuqi nga ana e ankuesit duhet të kishte proceduar me regjistrimin e F.Z.

Justifikimi i Shkollës për refuzimin e regjistrimit të nxënëses F.Z, pasi ndjekja e praktikës profesionale nga ana e saj do të përbënte rrezik për jetën dhe shëndetin e saj, në kushtet kur F. është vlerësuar nga KMCAP se ka nevojë për ndihmësin personal dhe Shkolla nuk ka në organikë një mësues ndihmës, është i pabazuar.

Rrezikshmëria në lidhje me llojin dhe natyrën e aktivitetit që duhet kryer, përbën një qëllim të ligjshëm, për të ndaluar apo për të refuzuar kryerjen e aktivitetit, përfshi këtu edhe ndjekjen e arsimit të mesëm profesional. Siguria e shëndetit dhe jetës së një personi prevalon dhe mund të justifikojë, ndalimin për të ndjekur arsimin e mesëm profesional. Çështja që shtrohet në këtë situatë

---

<sup>7</sup> GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Ruisisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

është, nëse midis këtij qëllimi të ligjshëm dhe mjetit të përdorur, pra refuzimit për të regjistruar në shkollë vajzën e ankuesit, ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjetit të përdorur dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në çështjen objekt shqyrtimi rezulton se, natyra e praktikës profesionale për drejtimin e përzgjedhur nga vajza e ankuesit, rezulton të jetë në përputhje me nivelin e pranueshëm të rrezikut për nxënësit që ndjekin shkollën, për sa kohë ato janë të lejuara të performohen. Praktika profesionale që kryhet pranë kësaj Shkollë, gjithashtu është brenda nivelit të pranueshëm të rrezikut edhe për nxënësit me aftësi të kufizuar, për sa kohë që Shkolla pranon që ka nxënës të tjerë me aftësi të kufizuar. Drejtuesja e Shkollës, ka vlerësuar se, për shkak se vajza e ankuesit sipas vendimit të KMCAP ka nevojë për përkujdesjen e vazhdueshme të një personi tjetër, kryerja e praktikës profesionale nga ana e vajzës së ankuesit paraqet rrezikshmëri shumë të lartë për aksidente për shëndetin dhe jetën.

Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ndjekjen e arsimit profesional nga personat me aftësi të kufizuar, nuk parashikojnë rregullime të posaçme për të vlerësuar nëse një nxënës me aftësi të kufizuar mundet ose jo të ndjekë arsimin e mesëm profesional. Me vendimin nr.170, datë 19.11.2019, Komisioneri ka konstatuar se, mosveprimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në kompetencën e të cilën hyn arsimi dhe formimi profesional, për të parashikuar procedurat për vlerësimin dhe ndjekjen e arsimit dhe formimit profesional nga personat me aftësi të kufizuara, ka vendosur nxënësen F.B në pozita më pak të favorshme, pikërisht për shkak të shkakut të mbrojtur “aftësisë së kufizuar”. Por, ndryshe nga situata në vendimin e cipërcituar, ku nxënësja F.B ka qenë e regjistruar në arsimin e mesëm profesional, pra nuk i ishte refuzuar regjistrimi nga ana e shkollës, në rastin objekt shqyrtimi, vajzës së ankuesit i është refuzuar regjistrimi në shkollë. Në vendimin nr.170 datë 19.11.2019, Komisioneri ka konstatuar se, për shkak të mungesës së akteve nënligjore rregullojnë mënyrën e vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në arsimin profesional, nxënësja F.B nuk ka mundur të ndjekë efektivisht shkollën. Në rastin e vajzës së ankuesit, ndohemi në një situatë të ndryshme kur sjellja e pretenduar si diskriminuese është konsumuar duke i refuzuar vajzës së ankuesit regjistrimin në shkollë.

Drejtuesja e Shkollës, në mungesë të rregullimeve të posaçme dhe pa patur asnjë kompetencë për të kryerë ajo vlerësimin e F.Z si person me aftësi të kufizuara, ka konkluduar se ndjekja e shkollës nga vajza e ankuesit do të përbënte një rrezik të lartë për të dhe në atë nivel, që në mungesë të një mësuesi ndihmës ose një personi tjetër që mund ta shoqëronte e kishte të pamundur që të ndiqte shkollën në drejtimin e përzgjedhur. Drejtuesja e institucionit, sikurse rezulton edhe nga informacioni i administruar nuk rezulton që, minimalisht, nëpërmjet një komisioni të brendshëm në shkollë, në kushtet kur nuk ka rregullim ligjor, të ketë vlerësuar në praktikë aftësitë e F.Z për të ndjekur ose jo praktikën profesionale në shkollë. F.Z, sikurse pretendohet nga Shkolla ka qëndruar në ambientet e Shkollës vetëm për pak orë në ditën e fillimit të vitit shkollor dhe nuk rezulton që të jetë përfshirë në ndonjë praktikë profesionale. Drejtuesja e Shkollës ka arritur në përfundimin se, vajza e ankuesit nuk mund të kryejë praktikën profesionale, jo duke gjykuar në mënyrë konkrete dhe objektive, por duke paragjykuar aftësitë e F.Z, vetëm për faktin se ajo është person me aftësi të kufizuara që ka nevojë për ndihmësin personal, për kapërcimin e pengesave në jetën e përditshme.

Komisioneri nuk mund të vlerësojë nëse praktika profesionale paraqet një nivel të tillë rreziku, i cili mund të rrezikojë shëndetin dhe jetën e saj, por vlerëson se një përfundim i tillë duhet të merret nga një komision multidisiplinar për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara për ndjekjen e arsimit të mesëm profesional, duke bërë një vlerësim individual dhe jo duke paragjykuar aftësitë e F., për shkak të mbështetjes me ndihmës personal që ajo përfiton si person me aftësi të kufizuara.

Rezulton se, F.Z i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm e të pabarabartë edhe në raport me nxënësit e tjerë me aftësi të kufizuara të cilët janë regjistruar në shkollë. Kjo diferencë në trajtim midis F. dhe nxënësve të tjerë me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollë bazohet në llojin/shkallën e dëmtimit. Ndërsa F.Z është vlerësuar person me aftësi të kufizuara grupi i parë, nxënësit e tjerë janë vlerësuar si persona me aftësi të kufizuara grupi i dytë. Është pikërisht lloji/shkalla e dëmtimit që kushtëzon edhe nevojën për përfitimin ose jo të ndihmës personal/kujdestari nga personi me aftësi të kufizuara.

MFE nuk ka miratuar akoma draft-udhëzimin që do të mundësonte vlerësimin dhe mbështetjen me mësues ndihmës të personave me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin e mesëm profesional. Referuar informacionit të vendosur në dispozicion nga AKPA, në lidhje me parashikimet në këtë draft udhëzim, rezulton se, sikurse edhe duhet të jetë, vlerësimi dhe nevoja për mësues ndihmës për personat me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin profesional, duhet të kryhet nga një komision multidisiplinar, i përbërë nga mjekë, psikologë, punonjës social dhe përfaqësues nga AKPA.

Sa më sipër nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis qëllimit të ligjshëm të synuar, që është mbrojtja e shëndetit dhe jetës së vajzës së ankuesit dhe mjetit të përdorur në rastin konkret, pra refuzimit për ta regjistruar F.Z në klasën e X të arsimit të mesëm profesional, pranë kësaj Shkolle. Nuk rezultoi e provuar se është bërë një vlerësim i vërtetë, objektiv dhe i individualizuar për rastin e vajzës së ankuesit. Komisioneri gjykon se, justifikimi i shkollës për refuzimin e regjistrimit të F.Z, nuk është objektiv dhe i arsyeshëm. Për rrjedhojë, në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, trajtimi diferencues dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar F.Z, përbën diskriminim.

Në konkluzion sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, F.Z është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuara, në të drejtën për arsim, nga ana e Shkollës së Mesme Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër. Për rrjedhojë Shkolla e Mesme Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, sipas parashikimeve në nenin 3, pikat 1 dhe 2, nenin 5, pika 1 dhe nenin 17, pika 1, gërma “c” dhe pika 2, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri marrjen e masave për pranimin e vajzës së tij në shkollë dhe vendosjen mësuesit ndihmës. Në vlerësim të kësaj kërkesë dhe bazuar në kompetencat ligjore, Komisioneri vlerëson se:

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe

*një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ky ligj në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit ose parandalimin e situatave diskriminuese. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.*

Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj F.Z, e cila është viktimat e sjelljes diskriminuese, konsiston pikërisht në refuzimin nga ana e Shkollës së Mesme Teknike të Pyjeve “Kolë Margjini”, Shkodër për ta regjistruar atë në klasën e X të arsimit të mesëm profesional. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e regjistruar F.Z në shkollë.

Në lidhje me kërkesën e ankuesit për vendosjen e mësuesit ndihmës, Komisioneri vlerëson se nuk mund të disponojë në lidhje me këtë kërkim, pasi kjo e drejtë nuk ka lindur akoma, për sa kohë që vajza e ankuesit nuk është regjistruar zyrtarisht në shkollë.

Në funksion të parandalimit në të ardhmen të situatave diskriminuese, Komisioneri thekson nevojën urgjente për miratimin nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të aktit nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve, procedurës së vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës, për personat me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin dhe formimin profesional. Komisioneri nxit Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, që të rishikojë mundësinë e mbledhjes dhe vlerësimit nga komisioni multidisiplinar në juridiksionin e saj, të rasteve për të cilat shkolla ka paraqitur kërkesën, deri në rregullimin e posaçëm të situatës lidhur me vlerësimin dhe caktimin e mësuesit ndihmës në arsimin e mesëm profesional.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11, 12 dhe 13, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të F.Z, në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Shkollës së Mesme Teknikë Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër.
2. Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, Shkollës së Mesme Teknikë Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër, duhet të marrë masa urgjente për regjistrimin e F.Z në shkollë.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Shkolla e Mesme Teknikë Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Me qëllim parandalimin në të ardhmen të sjelljeve diskriminuese, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duhet të marrë masa urgjente për miratimin e aktit nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve, procedurës së vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës, për personat me aftësi të kufizuara ndjekin arsimin dhe formimin profesional.
6. Rekomandohet Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër, që të rishikojë mundësinë e mbledhjes dhe vlerësimit nga komisioni multidisiplinar në juridiksionin e saj, të rasteve për të cilat shkolla ka paraqitur kërkesën, deri në rregullimin e posaçëm të situatës lidhur me vlerësimin dhe caktimin e mësuesit ndihmës në arsimin e mesëm profesional.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

## **KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku : Aftësia e kufizuar  
Fusha : Arsim  
Lloji i vendimit: Diskriminim